



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:055386  
Datë: 06.06.2024  
Numri i dokumentit: 05792560

**C.nr. 2441/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.B. nga P. i përfaqësuar sipas autorizimit nga N.P. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ndërmarrja “N.I.P.F.” L.L.C. me seli në F., me numër të biznesit..., e përfaqësuar sipas autorizimit nga M.D., avokat nga Prishtina, lidhur me çështjen e kompensimit të dëmit jo material dhe material, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në prani të paditësit me të autorizuarin e tij dhe të autorizuarit të paditurës, ndërsa me datë 06.06.2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET NË TËRËSI E PA BAZUAR** kërkesëpadia e paditësit M.S. nga P., me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura Ndërmarrja “N.I.P.F.” L.L.C. me seli në F. për shkak të lëndimit në vendin e punës me datë 03.09.2009, t'i paguaj shumat si në vijim: për dhimbje fizike shumë prej 8,000.00 euro, për frikën e pësuar shumë prej 6,000.00 euro, për zvogëlim të aktiviteti jetësore në shkallën prej 10% shumë prej 10,000.00 euro, për ushqim të përforcuar për një vit 1,800.00 euro, për ndihmën e huaj për një vit 1,800.00 euro, për shërim klimatik dy herë në vit për dy vite rresht 2,100.00 euro, dhe në emër të fitimit të humbur për shkak të pushimit mjekësor për periudhën kohore 01.05.2009 deri 31.08.2013, shumë prej 10,001.12 euro, të gjitha këto me kamatë si për mjetet e afatizuara pa destinim të caktuar nga parashtrimi i padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjyqimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. Secila nga palët i bartë për vete shpenzimet e procedurës.**

**A r s y e t i m**

Paditësi M.S. me datë 18.05.2011 ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Ndërmarrja “N.I.P.F.” L.L.C. me seli në F., përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material mbi bazën e lëndimit në punë. Përmes padisë ka theksuar se ka qenë i punësuar te e paditura, në vendin e punës si elektrosaldues. Me datën 03.09.2009 deri sa ka qenë i angazhuar në saldimin e kabrave – bazave të kulmit në ndërtesën e P. Sh. në katin e..., duke punuar në një pjesë ku ishte e pamundur të vendosën skelat, dhe në të njëjtin vend ishte improvizuar një urë me dërrasa, dhe në momentin kritik pasi që kishte hipur në këtë urë, për saldimin e bazave të kulmit të ndërtesës ka rrëshqitur nga dërrasa duke u rrëzuar nga një lartësi

prej 6–7 metra, nga ku ka rënë në bazamentin e ndërtesës. Ka shtuar se gjatë rënies me pjesë të ndryshme të trupit ka goditur kryqëzat e skeleve, dhe menjëherë pas rrëzimit nga punëtorët prezentë është dërguar në qendrën emergjente në QKUK ku edhe është konstatuar se ka pësuar lëndime trupore. Më tutje, ka theksuar se në momentin kur ka ndodhur lëndimi prezent kanë qenë edhe dëshmitarët Xh.B., R.R., M.A. dhe mbikëqyrësi i firmës “M.” R.A..

Duke vepruar sipas kësaj padie, Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 04.02.2015 ka marr aktgjykimin me numër C.nr. 956/11 përmes të cilit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë e paditura në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit me aktvendimin CA.nr.243/16 të datës 13.03.2020 e ka prish aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Gjykata e Apelit përmes aktvendimit të lartcekur, i ka rekomanduar gjykatës së shkallës së parë që në ri procedurë, të eliminoj të metat lidhur me marrjen e mendimit nga eksperti për siguri në punë, të konstatoj faktin nëse paditësi në ditën kritike ishte trajtuar në Qendrën Emergjente në QKUK dhe të ftojë ekspertët mjekësor në seancën e shqyrtimit kryesor për të dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me ekspertizat mjekësore, dhe pas kësaj të krijohen kushtet ligjore për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, si dhe për vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në zgjidhjen e këtij kontesti.

Gjykata duke vepruar sipas sugjerimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, ka caktuar seancën përgatitore dhe seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilat seanca paditësi ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj të precizuar, duke kërkuar nga gjykata që e njëjta të aprovohet dhe të detyrohet e paditura për shkak të lëndimit në vendin e punës me datë 03.09.2009, t'i paguaj shumat si në vijim: për dhimbje fizike shumë prej 8,000.00 euro, për frikën e pësuar shumë prej 6,000.00 euro, për zvogëlim të aktiviteti jetësore në shkallën prej 10% shumë prej 10,000.00 euro, për ushqim të përforcuar për një vit 1,800.00 euro, për ndihmën e huaj për një vit 1,800.00 euro, për shërim klimatik dy herë në vit për dy vite rresht 2,100.00 euro, dhe në emër të fitimit të humbur për shkak të pushimit mjekësor për periudhën kohore 01.05.2009 deri 31.08.2013, shumë prej 10,001.12 euro, të gjitha këto me kamatë si për mjetet e afatizuara pa destinim të caktuar nga parashtrimi i padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimin nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në shumë prej 1,218.00 euro të konfirmuar me vendimin e mëparshëm, 150.00 për ekspertizën e nxjerr në procedurën e rigjykimin, dhe nga 270.00 euro për përfaqësim në gjashtë seanca të mbajtura në rigjykim, e në shumë e përgjithshme prej 2,988.00 euro.

E paditura përmes përgjigjes në padi dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar padinë dhe kërkesën e saj, si për nga baza e po ashtu edhe për nga lartësia. Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave pala paditëse nuk e ka provuar bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë, pasi që nuk është vërtetuar vendi dhe data e ndodhjes së lëndimit të paditësit, po ashtu, edhe lëshimi i të njëjtit me rastin e kryerjes se detyrave të punës. Ka shtuar se, lidhur me lartësinë si dhe lëndimet e paditësit të njëjtat janë konstatuar përmes dokumenteve dhe ekzaminimit i cili ka ndodhur në një periudhë të largët. Lidhur me kategoritë tjera pala paditëse nuk ka provuar me prova konkrete, andaj nuk mund të aprovohet një kërkesë e cila nuk

është provuar. Mbi bazën e të gjitha këtyre, gjykatës me rastin e vendosjes i ka propozuar që kërkesëpadia e palës paditëse të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës ka kërkuar që të vendoset mbi bazën e suksesit në procedurë dhe të njëjtat nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës e datës 01.03.2009, vendimi për pensionin e personave me aftësi të kufizuar i lëshuar në emër të paditësit, ekspertiza mjekësore e datës 07.11.2012, ekspertiza nga lëmia e aktuaristikës e datës 31.12.2014, kërkesa për marrjen e dokumenteve në arkivin qendror në QKUK me datë 02.02.2015, vërtetimi nga Qendra Rajonale Prishtinë - Departamenti i Administratës Pensionale i datës 08.01.2015, kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës e datës 30.12.2009, njoftimi nga Klinika Emergjente e QKUK-së i datës 29.03.2023, ekspertiza e sigurisë dhe e mbrojtjes në punë e datës 22.04.2023, procesverbali i trajnimit i datës 05.01.2009 së bashku me listën e pjesëmarrësve, formulari i përshkrimit të punës i datës 05.01.2009 në emër të paditësit, ekspertiza nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë e datës 21.02.2024, si dhe në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar R.R. dhe Xh.B..

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e refuzoj në tërësi të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Fillimisht, gjykata vlerëson se, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi M.B. ka qenë i punësuar te e paditura, dhe atë në periudhën 01.03.2009 deri me datën 31.12.2009, e pastaj nga data 01.01.2010 deri me datën 31.03.2010, fakt që provohet edhe me kontratat e punës me numër 354 e datës 01.03.2009 dhe e datës 01.01.2010.

Kontestuese në këtë çështje juridike kontestimore ishte baza juridike e kërkesëpadiës, kjo për faktin se e paditura e konteston pretendimin e paditësit se lëndimi ka ndodhur në vendin e punës dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë e konteston edhe lartësinë e kërkesëpadiës.

Meqenëse nga fletëlëshimi i lëshuar nga Qendra Emergjente pranë QKUK-së nuk mund të konstatohej data se kur paditësi e ka vizituar këtë qendër, e po ashtu ky fletëlëshim nuk përmban asnjë të dhënë, apo përshkrim lidhur me gjendjen shëndetësore të paditësit me rastin e vizitës së kësaj qendre, gjykata me datë 06.03.2023 i është drejtuar Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - Qendrës Emergjente, me kërkesë për sigurimin e informatave dhe atë nëse paditësi M.I. e ka vizituar këtë Qendër Emergjente nga data 03 shtator 2009 deri me datën 05 shtator 2009. Nga njoftimi i pranuar nga Klinika Emergjente e QKUK-së i datës 29.03.2023, gjykata konstatoj se paditësi me datë 15.09.2009 ka vizituar Qendrën Emergjente në QKUK, ku pas trajtimit të marr është liruar për trajtim shtëpiak. Sipas këtij njoftimi, kopja e raportit nuk gjendet në këtë Klinikë, sepse sipas tyre pacienti i ka marr me vete të dy kopjet, duke e njoftuar gjykatën se kjo është e tëra çka mund të ofrohet nga Qendra Emergjente, pasi që lista e emergjencës është marr nga vet pacienti.

Me qëllim që të vërtetohet qartë gjendja faktike dhe eventualisht lëshimet eventuale të paditësit dhe të paditurës, gjykata me propozimin e palës paditëse, ka nxjerrë provën me ekspertizë nga lëmia e sigurisë në punë. Eksperti për mbrojtje dhe siguri në punë A.K., përmes ekspertizës së hartuar me datë 22.04.2023, në raport me përgjegjësinë dhe lëshimet e të paditurës ka konstatuar se e njëjta nuk ka bërë vlerësimin e riskut për vendin e punës elektro saldues, nuk i ka dhënë ekipës së salduesve Urdhëresën e Punës më shkrim e cila përmban vendin e punës, punët që duhet të kryhen, emrat e punëtorëve, materialet e përdorura dhe masat e sigurisë, nuk ka kryer siç duhet punën me rastin e vendosjes së skeleve në objekt, nuk ka bërë trajnimin e punëtorëve nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, nuk ka dërguar punëtorin në kontroll mjekësor, nuk ka mbajtur dokumentacionin e nevojshëm teknik gjatë realizimit të punimeve dhe nuk ka caktuar person përgjegjës në kuadër të kompanisë për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Ndërsa, në raport me përgjegjësinë e paditësit ka konstatuar se meqenëse paditësi kishte përvojë të gjatë në kryerjen e kësaj pune, të njëjtit i ka munguar koncentrimi i duhur duke shkelur në pjesën më tej lëshim të platformës shkelëse të skelës e cila ka ndikuar në ngritjen e saj dhe rënien e tij në pllakë betoni dhe nuk ka analizuar paraprakisht vendin ku është dashtë të saldoj dhe nëse ka qenë e pamundur të kryej veprime në pozitën ekzistuese të skelës, është dashtë të informoj udhëheqësin e tij për të bërë zgjidhje të sigurt dhe në rast të përgjigjes negative nga ana e udhëheqësit, punëtori ka pas të drejtë të refuzoj kryerjen e punëve nga një pozitë e pa sigurt.

E po ashtu, sipas propozimit të paditurës, e cila i ka kundërshtuar konstatimet e ekspertizës së lartcekur, gjykata ka aprovuar propozimin për nxjerrjen e ekspertizës së dytë nga mbrojtja dhe siguria në punë. Eksperti për mbrojtje dhe siguri në punë Gj.V. përmes ekspertizës së hartuar me datë 21.02.2024 ka arritur në përfundime të njëjta sikurse ekspertiza paraprake. Për të ofruar sqarime lidhur me konstatimet e tij të dhëna përmes ekspertizave sikurse më lartë, gjykata ka ftuar të dy ekspertët në seanca gjyqësore, të cilët i janë përgjigjur pyetjeve të palëve ndërgjyqëse dhe të gjykatës.

Sipas propozimit të paditësit, gjykata ka nxjerrë provat përmes ekspertizave mjekësore dhe atë nga eksperti mjekësor ortoped - traumatolog Dr. A.G., eksperti mjekësor neurokirurg B.K. dhe eksperti mjekësor neuropsikiatër Dr. F.D.. Ekspertët mjekësor, përmes ekspertizës së datës 07.11.2012 kanë konstatuar se paditësi, si pasojë e lëndimit në punë ka pësuar lëndime të rënda trupore. Ekspertët kanë konstatuar se paditësi ka pësuar dhembje fizike të intensitetit shumë të rëndë për një orë deri sa është transferuar në qendrën emergjente nga momenti i aksidentit, dhembje fizike të intensitetit të rëndë ka pësuar për shtatë ditë sa ka zgjatur hospitalizimi në operacionin e parë dhe të dytë, dhembje fizike të intensitetit të mesëm për tre muaj që është e dokumentuar me dokumentacion mjekësor kur dhembjet kanë qenë nga infeksioni që ka pësuar post operativ, dhembje fizike të intensitetit të ulët ka edhe sot sidomos në sforcime fizike, gjatë qëndrimit ulur si dhe qëndrimit në këmbë. Ekspertët kanë konstatuar se paditësi nuk ka pësuar shëmtim trupor. Ndërsa, në raport me frikën kanë konstatuar se paditësi e ka parë momentin e rrëzimit, aty ai ka pas kohë psikologjike/sekonda psikologjik për të menduar se gjendja determinon rrezik dhe kërcënim për jetën, në këtë mënyrë i njëjti e ka përjetuar frikën primare e cila ka zgjatur vetëm disa sekonda. Kurse, lidhur me frikën sekondare, kanë konstatuar se e njëjta ka qenë e intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 2 javë, ndërsa frika sekondare e intensitetit mesatar e cila ka zgjatur 6 muaj, dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët e cila sipas ekspertëve mjekësor

nënkupton shqetësimet e herëpashershme, si pagjumësi, nervozë, të cilat janë paraqitur në vijim dhe lidhen me pasojat e aksidentit. Ekspertët mjekësor kanë konstatuar se aktiviteti i përgjithshëm jetësor në shkallen 10% ndërsa ka zvogëlim 100% për punë të rënda fizike. Po ashtu, ekspertët mjekësor kanë vlerësuar se ka qenë i nevojshëm pushimi mjekësor për një vit, për shkak të operimeve dhe terapisë antituberkulare për shkak të infeksionit post operativ, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë për gjashtë muaj periudhë kjo që paditësi ka qenë i detyruar të qëndrojë në regjim shtrati. Sa i përket ushqimit të përforcuar, paditësi ka pasur nevojë në periudhë një vjeçare për shkak të infeksionet të pësuar post operator, ndërsa për rehabilitim kishte nevojë dy herë në vit nga 21 ditë, pas trajtimit të infeksionit post operator për dy vite rresht. Gjykata ekspertët mjekësor i ka ftuar në seancën e shqyrtimit kryesor, të cilët i kanë dhënë sqarimet e nevojshme duke ju përgjigjur pyetjeve të palëve ndërgjyqëse dhe të gjykatës.

Po ashtu, sipas propozimit të paditësit gjykata ka nxjerr provën përmes ekspertizës nga lëmia e aktuaristikes e datës 31.12.2014, përmes së cilës eksperti ka llogaritur fitimin e humbur gjatë kohës sa paditësi ka qenë i pa punësuar dhe atë nga data 01.05.2011 e deri me datë 31.08.2013. Eksperti ka konstatuar se shuma e kalkuluar gjatë kësaj periudhe është në lartësi prej 9,187.64 euro, ndërsa duke përfshirë edhe kamatën arrin në lartësi prej 10,001.12 euro.

Në cilësi të dëshmitarit, në seancën e shqyrtimit kryesor dëshmitari R.R. ka deklaruar se me paditësin ka punuar së bashku në një vend të punës te e paditura dhe se më kujtohet shumë mirë ngjarja kur ka ndodhur aksidenti gjatë kryerjes së punës të saldimit në katin e 18-të, objekti i ish "R.", tani aty janë të vendosura disa ministri. Ka shtuar se, gjatë kohës sa kemi qenë duke punuar së pari janë marr masat mbrojtëse në punë, janë vendosur skelet, skelet ne nuk i kemi vendosur por kanë qenë të vendosura nga ekipi tjetër i punëtorëve dhe skelet kanë qenë në një lartësi diku katër metra, meqenëse unë isha duke punuar në një punë tjetër, paditësi ka qenë duke punuar në të njëjtën punë saldimit dhe vetëm për një moment e kam parë që është rrezuar nga skelet dhe ka ra në plato të betonit. Tutje ka shtuar se, meqenëse e ka parë se ka ra poshtë menjëherë ka shpejtuar, ka zbrit nga skelet e ka parë që nuk ka vetëdije me ç'rast e ka thirr Xh.B. dhe R.A. përgjegjës in e salduesve duke i marr veprimet për t'i dhënë ndihmën e parë. Në fund ka deklaruar se nuk ka marr pjesë për të dërguar në spital, por në spital e ka dërguar Xh.B. dhe R.A..

Ndërsa, dëshmitari Xh.B. ka deklaruar se kam punuar tek i padituri ndërsa, tani e një vit nuk punoj më aty pasi që kam punëtorin time private. Me sa di unë punëdhënësi ka marrë punime për të kryer punët lidhur me meremetimin-riparimin në ish pallatin e "R." në P.. Unë kam punuar në grupin e punëtorëve elektrosaldues në katin e...dhe neve na është kërkuar që nga F. të vijmë në P. për të kryer disa punime veçanërisht, ato që kanë pasur të bëjë me saldimit. Në ditën kritike kur ka ndodhur aksidenti ne kemi qenë si grup prej 4 punëtorësh por, kanë qenë edhe grupe tjera të punëtorëve që kanë punuar në pjesë tjera. Atë ditë na është dhënë detyra të punojmë në katin e..., kur kemi ardhur në vendin e punës skelet kanë qenë të vendosura nga ekipi tjetër dhe skelet kanë qenë dy katëshe diku në lartësi 4 m. Atë ditë kemi punuar nga 2 vetë, dy kanë punuar lartë dy poshtë dhe gjatë saldimit duke punuar unë e kam parë M. duke rënë poshtë dhe fillimisht të themë të drejtën lëndimet kanë qenë skajshmërisht të rënda dhe kemi menduar se veç ky ka vdekë. E kemi thirr menjëherë shefin tonë sepse ka qenë afër aty dhe e ka siguruar një automjet të "M." dhe na ka ndihmuar për me e dërgu në emergjencë. Unë kam qenë me M. prezentë kur e

kemi dërguar në emergjencë ku edhe i është dhënë ndihma mjekësore. E di që jemi munduar që sa më parë me mbërri në emergjencë dhe ka pas ngapak kolonë në trafik, por kemi vepruar sa më shpejtë aq sa na kanë lejuar kushtet. E di që në Qendrën Emergjente në momentin kur e kemi dorëzuar, personeli ka vepruar aq shpejtë dhe ka pas një angazhim të madh për t'i dhënë ndihmën e parë. Në Qendrën Emergjente unë kam qëndruar deri sa i janë dhënë disa shërbime M., si incizimet, fotografimet, por meqenëse në atë kohë e kishim edhe orarin që na bartnin autobusët për tu kthyer në F., pastaj unë kam shkuar në F. – shtëpi.

Bazuar në faktet e lartcekura, e duke marr për bazë se paditësi pretendon se është lënduar me datë 03.09.2009, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e ligjeve të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet se ka ndodhur lëndimi në punë. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se në këtë rast gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (GZ e ish-RSFJ, nr. 30, datë 30.03.1978 ), Ligjit Nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës dhe dispozitat e Rregullores Nr.2004/01 për Masat Higjienike dhe Teknike të Sigurisë në Punë.

Bazat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, përcaktohen me nenin 154 të LMD-së, sipas të cilit: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.”* Me këtë dispozitë, rregullohet përgjegjësia mbi bazën e fajësisë, e cila varet nga raporti subjektiv i shkaktuesit të dëmit me dëmin e shkaktuar, e po ashtu, me të njëjtën është parashikuar edhe përgjegjësia objektive për shpërblimin e dëmit pavarësisht nga faji, në rastet kur dëmi është shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo nga veprimtaria e rrezikshme. Më tutje, në raport me përgjegjësinë objektive sipas sendit apo veprimtarisë së rrezikshme, LMD parasheh dispozita të veçanta nga neni 173 deri tek neni 177. Njëkohësisht, nga përmbajtja e kësaj dispozite, rezulton se për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet dëmi; b) dëmi të jetë shkaktuar me veprimin apo mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) të ekzistojë aftësia deliktore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit apo mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit.

Po ashtu, neni 154 i LMD-së parasheh se për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj, në lidhshmëri me këtë dispozitë, Ligji Nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, në nenin 2 paragraf 10 parasheh se: *“Punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjen profesionale që ka të bëjë me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.”*

Ndërsa, neni 2 paragraf 1 i Ligjit Nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, parasheh: *“Punëdhënësi është i obliguar të krijoj kushtet për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës për punëmerrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar për ti mbuluar të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve profesionale.”* Kurse, me paragrafin 2 të këtij

neni përcaktohet se: *“Punëdhënësi është i obliguar të organizoi dhe të ndërmer masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, paisjet, veglat, vendin e punës, mundësitë për të shkuar në vendin e punës.”*

Kurse më tutje, me nenin 2 paragrafi 1 të Rregullores Nr.2004/01 është paraparë se: *“Punëdhënësi është i obliguar që të gjitha vendet e punës dhe ato që lidhen me punën (punishtet, punëtoritë, ndërtesat, lokalet për pushim, ushqim, pastrim etj.) mjetet e punës, mjetet për sigurinë në punë, t’i rregulloj dhe t’i mirëmbajë në atë mënyrë, që të punësuarit dhe të tjerët të jenë të mbrojtur nga fatkeqësitë në punë, sëmundjet profesionale dhe sëmundjet tjera lidhur me punën.”*

Nga interpretimi i dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligjit Nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës dhe dispozitat e Rregullores Nr.2004/01 për Masat Higjienike dhe Teknike të Sigurisë në Punë si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, gjykata arriti në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Mbi bazën e provave të administruara, paditësi nuk ka arritur t’i vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e vet, nuk ka arritur të vërtetoj lidhjen kauzale lidhur me veprimin apo mosveprimin dhe dëmin e shkaktuar, përkatësisht nuk janë plotësuar parakushtet ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurës, për kompensimin e dëmit paditësit. Rrjedhimisht, nuk është arritur të konstatohet fakti vendimtar se paditësi është lënduar në vendin e punës me datën 03.09.2009. Kjo për faktin se, me asnjë dokument zyrtar të institucioneve përgjegjëse përfshirë edhe raportet mjekësore nuk provohet fakti se paditësi me datë 03.09.2009, është lënduar në punë përderisa ka qenë duke punuar tek e paditura. Për më shumë, përmes njoftimit nga Klinika Emergjente e QKUK-së i datës 29.03.2023, gjykata konstatoj se paditësi me datë 15.09.2009 ka vizituar Qendrën Emergjente në QKUK, ku pas trajtimit të marr është liruar për trajtim shtëpiak, konstatim ky i cili nuk është në përputhje me pretendimin e paditësit, pasi që i njëjti pretendon se në Qendrën Klinike Emergjente është dërguar me datë 03.09.2009, dhe se në këtë qendër mjekësore është dërguar me lëndime të rënda dhe pa vetëdije.

Njëkohësisht, ekspertiza e parë e ekspertit për mbrojtje dhe siguri në punë A.K., e hartuar me datë 22.04.2023 për gjykatën nuk ishte e besueshme në raport me shkaqet e lëndimit në punë të paditësit. Kjo për faktin se, kjo ekspertizë nuk është e bazuar në asnjë provë materiale kur ka konstatuar se paditësi është lënduar në vendin e punës dhe duke kryer detyrat e punës. Në rastin konkret, eksperti me rastin e përgatitjes së ekspertizës është bazuar vetëm në deklaratën e paditësit, ndërsa pjesa tjetër e ekspertizës është vetëm përshkrim i përgjithshëm i rregullave që lidhen me kushtet dhe sigurinë në punë, mirëpo nuk ka ndonjë lidhshmëri me konstatime faktike nga vendi i ngjarjes. Lidhur me këtë, eksperti në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se me rastin e përgatitjes së ekspertizës, sa i përket skeleve dhe montimit të tyre, nuk ka pas asnjë dëshmi. Kurse, në raport me daljen në vend ngjarje ku paditësi pretendon se është lënduar, eksperti në bazë të intervistës me paditësin vlerëson se nuk ka ndonjë arsye për dalje në vend shikim për faktin se tani çdo gjë është ndryshuar. Po ashtu, edhe ekspertiza e dytë nga mbrojtja

dhe siguria në punë e përgatitur nga eksperti Gj.V. me datë 21.02.2024, kishte arritur në konstatime të njëjta sikurse ekspertiza paraprake. E njëjta për gjykatën nuk ishte provë e besueshme, për faktin se nga përmbajtja e saj nuk arrihen konstatime të bazuara, e njëjta në formë përshkruese përmban dispozita ligjore nga mbrojtja dhe siguria në punë, ndërsa përfundimet e saj i bazon në ekspertizën paraprake dhe në mungesën e të dhënave të cilat i ka kërkuar nga e paditura. Me këtë ekspertizë, nuk vërtetohet fakti se cilat kanë qenë lëshimet e të paditurës për të siguruar ambient të sigurt të punës, cilat veprime të paditurës kanë shkaktuar lëndimin e paditësit, apo cilat veprime është dashur t'i ndërmerret e paditura e nuk i ka ndërmarrë. Kjo ekspertizë përshkruan në mënyrë të përgjithshme dispozitat e Ligji Nr. 04/1-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Rregullores nr.2004/01, për masat higjienike dhe teknike të sigurisë në punë, pa dhënë asnjë përfundim se cilat janë lëshimet konkrete të paditurës të cilat janë pasojë, apo shkak në bazë të cilave ka ardhur deri te incidenti në punë. Andaj, kjo ekspertizë nuk e përcakton përgjegjësinë e të paditurës në raport me pretendimet e paditësit lidhur me lëndimin në vendin e punës dhe nuk mund të merret për bazë me rastin e vendosjes, pasi e njëjta është e pa pranueshme në përfundimet e saj.

Lidhur me ekspertizat e lartcekura, gjykata vlerëson se nuk është e mjaftueshme të konstatohet vetëm fakti se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura dhe mbi këtë bazë të arrihet në përfundim se lëndimi ka ndodhur në vendin e punës, sepse ky fakt vërtetohet nga kontrata e punës dhe nuk ishte kontestues në mes të palëve. Por vendimtare në këtë çështje kontestuese ka qenë vërtetimi i faktit se nëse lëndimet e paditësit kanë ndodhur në vendin e punës, duke përfshirë shkaqet të cilat do të ndikonin në shkaktimin e këtyre lëndimeve. Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se nga ekspertizat e lartcekura nuk është arritur të vërtetohet ky fakt, dhe në këtë rast barra e provës për të provuar faktin se i njëjti është lënduar në vendin e punës bie mbi palën paditëse, i cili nuk ka arritur me asnjë provë materiale të provojë së është lënduar në vendin e punës me datë 03.09.2009.

Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës nuk rezulton se është njoftuar Inspektorati i Punës, nga raporti i të cilit do të ishin përshkruar rrethanat mbi incidentin e ndodhur, e njëkohësisht do të krijohej një pasqyrë mbi faktet që do të ishin të rëndësishme për incidentin. Lidhur me këtë, duke marr për bazë faktin se, e paditura gjatë tërë kohës e ka kontestuar pretendimin e paditësit se i njëjti është lënduar në vendin e punës, gjykata vlerëson se ka qenë obligim i paditësit të njoftoj Inspektoratin e Punës, në mënyrë që të vërtetohet pretendimi së i njëjti është lënduar në vendin e punës dhe në qoftë se ka ndodhur cilat kanë qenë shkaqet, sepse përderisa punëdhënësi këtu e paditura e konteston faktin se incidenti ka ndodhur në vendin e punës, atëherë nuk mund të pritet se i njëjti do të lajmëroj rastin e lëndimit në punë.

Njëkohësisht, gjykata vlerëson se në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë raport të policisë, për të përshkruar incidentin e pretenduar nga paditësi. Po ashtu, nuk është bërë sigurimi i marrjes së provës menjëherë pas ndodhjes së incidentit, siç përcaktohet nga neni 379 deri tek neni 385 i LPK-së, ndërsa pas ndryshimit të gjendjes faktike, përkatësisht me largimin e skeleve nga vend punimi, fakt që nuk është kontestues nga deklarimet e palëve, si në shkresat e lëndës, është e pa mundur të jepet një mendim objektiv nga cilido ekspert, lidhur me rrethanat e ndodhjes së incidentit dhe vërtetimin e përgjegjësisë së të paditurës në shkaktimin e dëmit.



Gjykata i vlerësoj dhe i analizoj deklaratat e dëshmitarit R.R. dhe Xh.B. të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor, mirëpo nga të njëjtat e kishte të pa mundur të konstatonte faktin vendimtar se paditësi është lënduar në vendin e punës. Kjo për faktin se dëshmitë e tyre, nuk përputhën me asnjë provë të vetme materiale, në mënyrë që gjykata të krijoj lidhjen reciproke, në mes të provave materiale dhe deklaratave të dëshmitarëve. Në këtë mënyrë, në mungesë të dëshmimeve mjekësore dhe në mungesë të konstatimeve të pranueshme për gjykatën përmes ekspertizave për mbrojtje dhe siguri në punë, gjykata e kishte të pamundur të konstatoj lidhjen kauzale të lëndimeve të paditësit dhe atë nëse të njëjtat janë shkaktuar në vendin e punës, në kohën kur i njëjti pretendon, vetëm mbi bazën e deklarimeve të dëshmitareve.

Gjykata i vlerësoj edhe ekspertizat mjekësore të përgatitura nga ekspertët mjekësor ortoped – traumatolog, neurokirurg dhe neuropsikiatër, të cilët i kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me lëndimet e paditësit, mirëpo as përmes këtyre ekspertizave gjykata nuk arritur të konstatoj faktin se paditësi është lënduar në vendin e punës me datë 03.09.2009. Kjo për faktin se, e tërë ekspertiza është e hartuar mbi deklaratimet e paditësit dhe dëshmitë e tjera mjekësore, mirëpo me asnjërin prej tyre nuk konstatohet se paditësi në datën e caktuar ka marr shërbim mjekësor si pasojë e lëndimit në punë. Bazuar në dëshmitë mjekësore, mbi bazën e të cilave ekspertët mjekësor e kanë përgatitur ekspertizën, dhe atë udhëzimin e mjekut specialist të datës 22.09.2009 dhe datës 30.09.2009, raportet nga Klinika A. të datës 05.10.2009, fletëlëshimi me epikrizë i lëshuar nga QKUK Klinika e Neurokirurgjisë e datës 02.11.2009 dhe e datës 31.12.2009, e po ashtu edhe raportet e tjera specialistike nga Klinika E. i datës 21.04.2010 si dhe raporti nga Spitali i Përgjithshëm Rezonanca i datës 16.08.2010, gjykata nga të njëjtat konstatoj se paditësi ka realizuar vizita mjekësore, e po ashtu ka kryer operime, mirëpo të njëjtat kanë ndodh në data tjera, pas kohës kur paditësi pretendon se është lënduar në vendin e punës. Për me shumë, gjykata vlerëson se nuk është kompetencë e eksperteve mjekësor të cilët i kanë hartuar ekspertizat të konstatojnë nëse paditësi është lënduar në vendin e punës, mirëpo të njëjtit kanë për detyrë të përcaktojnë natyrën e lëndimeve dhe pasojat e shkaktuara nga këto lëndime.

Në të njëjtën kohë, gjykata e vlerësoj edhe ekspertizën nga lëmia e aktuaristikes e datës 31.12.2014, mirëpo meqenëse në rastin konkret nuk është vërtetuar së lëndimet të cilat janë konstatuar në ekspertizë paditësi i ka pësuar në vendin e punës, pra meqenëse nuk është vërtetuar baza e kërkesëpadsisë, gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e kësaj ekspertize, në raport me vendosjen lidhur me lartësinë e kërkesëpadsisë, lidhur me këtë kategori të kërkesës.

Gjykata me rastin e vendosjes ka vlerësuar të gjitha pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, e po ashtu ka vlerësuar edhe prova të tjera, mirëpo të njëjtat nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestimore.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi në këtë rast nuk ka arritur t'i vërtetojë faktet vendimtare mbi të cilat e mbështet kërkesën e vet edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, dhe atë duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, e po ashtu, edhe në nenin 319 paragraf 1 të të njëjtit ligj, i cili përcakton: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i*

*bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”, për çka gjykata përmes provave të administruara arriti të vërtetoj gjendjen faktike, dhe gjeti se nuk është arritur të konstatohet se e paditura mban përgjegjësi për shkaktimin e dëmit, për çka vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka refuzuar kërkesën e palës paditëse për kompensimin e shpenzimeve të procedurës, dhe ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e veta të procedurës, pasi pala paditëse e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar kërkesë për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 449, 452 paragrafi 1, e lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C.nr. 2441/2020, datë 06.06.2024**

**Gjyqtari**  
Argzon Muçaj

**KESHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.